



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivered	02-10-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitina Quantity
SKM/884/K	6361/2023		1/5



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1104/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1104/2023 të datës 22.08.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër masës disiplinore vërejtje me Nr. 35752/23 të datës 01.08.2023 të shqiptuar nga Udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile në Komunën e Vushtrrisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; në seancën për këshillim dhe votim, të datës 02.10.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.1104/2023 e datës 22.08.2023 e parashtruar nga ankuesi

**II. Anulohet** masa disiplinore "Vërejtje" me Nr. 35752/23 e datës 01.08.2023 e shqiptuar nga Udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile në Komunën e Vushtrrisë.

**III. Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrrisë, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale dhe regjistri përkatës i nëpunësit civil, masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ndaj ankuesit : punësuar sipas Akt Emërimit me Nr. 1125/15 të datës 02.11.2015 në pozitën "Zyrtar i Gjendjes Civile", në Komunën e Vushtrrisë, Udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile në Komunën e Vushtrrisë më datë 01.08.2023 ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetimin se më datë 31.01.2023 prej orës 14:45, zyrtari Xh.M është marr me një palë në sportelin numër 5 në zyrën e gjendjes civile dhe pas orës 15.:25 pala ankohet me arsyetimin se që një orë jam nëpër sportele dhe askush nuk merret me neve dhe tash po më than me pritë në sportelin numër 11...unë kërkova nga Xh për ta pyetur por ai kishte qenë në telefon për nja 5 minuta nuk e ndërprite fare bisedën në telefon, dhe pas konsultimit me zyrtarin Xh.M se cila është arsyeja e pritjes së kësaj pale, ai mu përgjigj me një mospërfillje, po citoj nuk është palë e inja edhe palë e V dhe ka me regjistruar një martesë të lidhur jashtë vendit, kur unë i thash që ti je marr me këtë palë për një orë në sportelin nr.8 dhe të kam pa dy herë gjatë lëvizjes sime, ai mu përgjigje po citoj pse çka bahet nëse pret pala një orë, nuk bahet nami...

Ankuesi, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 01.08.2023, përmes postës më datë 18.08.2023 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 22.08.2023, duke u regjistruar nën shenjë A.nr.1104/2023 me numër protokolli 5771/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Komunën e Vushtrrisë. Ndërsa Këshilli më datë 04.09.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 5771/2023 të datës 22.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtja me Nr. 35752/23 të datës 01.08.2023 të shqiptuar nga Udhëheqësi i Zyrës së Gjendjes Civile në Komunën e Vushtrrisë; Dokument identifikimi i ankuesit; Zarfën e datës 18.08.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 04.09.2023; Akt Emërimit me Nr. 1125/15 të datës 02.11.2015; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Gjendjes Civile datë 02.11.2015; Formulari për caktimin e objektivave për ankuesin për vitin 2023; Evidencën e performancës së nëpunësit gjatë orarit të punës 2023; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës i datës 01.02.2021 dhe 20.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore "Vërejtje" të datës 01.08.2023, pretendon që kjo masë është shqiptuar në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, ngase nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike për faktin se ne i kemi detyrat e ndara dhe unë nuk i kryej



regjistrimet e faktit të lindjes, vdekjes dhe martesave ngase kjo është përgjegjësi e një kolege tjetër, po ashtu mbikëqyrësi nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat sepse nuk ka mundur të vërtetoj nëse kam pasur një sjellje të tillë.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe me rastin e vendimmarrjes Kolegji i Këshillit u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën disiplinore të nëpunësve civilë, përkatësisht nenin 45 i cili ka përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, nenit 46 ku citohet se: 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta...Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbyllja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbylljen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbylljen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë", ndërsa sipas këtij neni shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar, nenin 47 i cili ka paraparë se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil", nenin 50, i cili ka specifikuar se: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore".

Referuar dispozitave të marra për bazë si më lartë me rastin e vendimmarrjes si dhe gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit të kontestuar përmes të cilit ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "Vërejtje" e datës 01.08.2023, Kolegji i Këshillit, në bazë të provave materiale të lëndës, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "Vërejtje" nuk ka arritur të konstatoj drejtë gjendjen faktike, ngase nuk ka asnjë dëshmi që ndonjë prej palëve të ketë parashtruar ndonjë ankesë lidhur me mos marrjen e

shërbimit të kërkuar, po ashtu në provat e lëndës nuk ekziston asnjë dëshmi që mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë të ketë ftuar në takim ankuesin për të diskutuar lidhur me rastin, dhe nuk ka dëshmi që ankuesi të jetë shprehur me fjalën siç pretendon mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, ngase për këtë çështje nuk është siguruar asnjë dëshmi me shkrim.

Kolegji i Këshillit, në shqyrtim të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe në vlerësim të të gjitha provave të lëndës, konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave e që është obligim sipas nenit 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase me asnjë provë të vetme nuk është argumentuar ajo që është përshkruar në aktin për shqiptimin e masës disiplinore të datës 01.08.2023, edhe pse në kërkesën për përgjigje në ankesë janë kërkuar provat relevante, mirë në përgjigjen në ankesë të datës 04.09.2023 të dërguar nga Komuna e Vushtrrisë është konfirmuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ka dërguar vetë shkresën për ndarjen e punës dhe evidencës e nëpunësit civil, e që në rastin konkret mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore nuk ka arritur të konstatoj faktin se në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe ndarjes së përgjegjësisive për zyrtarë, a ka qenë ankuesi përgjegjës për kryerjen e një shërbimi të tillë siç është regjistrimi i faktit të martesës së lidhur jashtë vendit.

Duke u bazuar në konstatimet si më lartë, e në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë ka konstatuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankuesit nuk ka marrë parasysh të gjitha elementet për përcaktimin e drejtë dhe të plotë të përgjegjësisë së ankuesit si dhe parimet për individualizmin e masës disiplinore, sepse sipas aktit të kundërshtuar me ankesë dhe shkresave të lëndës nuk është konfirmuar fakti se nga veprimi i ankuesit të jetë shkaktuar ndonjë pasojë apo dëm për institucionin dhe se përjashtimisht vërejtjes së datës 01.08.2023, me asnjë dëshmi nuk është vërtetuar se ndaj ankuesit më parë ka pasur ndonjë vërejtje të shqiptuar e cila është në dosjen personale të tij, përkundrazi në bazë të vlerësimeve të rezultateve në punë, rezulton se ankuesi nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për vitin 2022, 2021 dhe 2022 është vlerësuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë për realizimin e objektivave është vlerësuar me notë të përgjithshme 4 apo "Shumë mirë".

Ndërlidhur me at që u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se masa disiplinorë "Vërejtje" e datës 01.08.2023 e shqiptuar ndaj ankuesit është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 45 si dhe nenit 50 paragrafi 1 të njëjtit ligj, dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, kështu që e njëjta është e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht Udhëheqësi i Njëjesisë së Burimeve Njerëzore i Komunës së Vushtrrisë, në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, është i obliguar që bëjë heqjen e masës disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e tij.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1104/2023, datë 02/10/2023

**Avdyl BEKTESHI**

*Avdyl Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Arben MEHMETI**

*Arben Mehmeti*  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Vushtrisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.